

UDHËZIM
Nr. 665, datë 4.10.2018

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 837, DATË 10.2.2017, TË
MINISTRIT TË TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, “PËR MIRATIMIN E
METODOLOGJISË PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE
PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHTETËRORE PËR OFRUESIT E
SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të germës “ç”, të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”,

UDHËZOJ:

1. Në udhëzimin e ministrit nr. 837, datë 10.2.2017, lidhja nr. 1, zëvendësohet me lidhjen A bashkëlidhur këtij udhëzimi.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve, të gjitha bashkitë, të gjithë sh.a. ujësjellës-kanalizime.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare

**MINISTRI I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Damian Gjikhuri**

Lidhja A

METODOLOGJI

PËR KRITERET DHE PROCEDURAT PËR SHPËRNDARJEN DHE PËRDORIMIN E SUBVENCIONEVE SHITETËRORE PËR OFRUESIT E SHËRBIMEVE NË SEKTORIN E UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE

Kjo metodologji është hartuar në zbatim të germës “dh”, të pikës 13, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 11.7.2018, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve dhe Infrastrukturës së Mbetjeve”, dhe në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, detajimi i fondit të subvencionit për çdo shoqëri aksionare të ujësjellës-kanalizimeve (sh.a. UK) dhe përdorimi i tij nga përfituesit, do të bëhet si më poshtë:

1. Subvencioni do të shpërndahet nga AKUM-ja në masën e planifikuar në ligjin vjetor të buxhetit dhe të gjitha shtesave të tjera të bëra me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Vlerësimi i nevojave për subvencione, si dhe detajimi dhe shpërndarja e subvencionit nga AKUM-ja, do të bazohet në:

2.1 Të dhënat e raportuara nga ofruesit e shërbimeve sh.a. UK, pranë AKUM-së, në përputhje me kërkesat, formatin dhe afatet e përcaktuara.

2.2 Në ecurinë e përmbushjes së kriterëve të përcaktuara në kontratat e performancës, lidhur ndërmjet palëve (AKUM-ja e bashkisë përkatëse).

3. Subvencioni i përfituar sipas pikës 1 të kësaj metodologjie do të përdoret nga sh.a. UK:

3.1 Për të përballuar mbulimin e “Kostos direkte të operimit (KDO)” (diferencën = faturime – kosto direkte e operimit), për të tria shërbimet publike që ofrohen në sektor: a) furnizim me ujë të pijshëm; b) kanalizime; c) trajtim e përpunim të ujërave të ndotura;

3.2 Për të mbështetur përmirësimin e performancës së sh.a. UK që operojnë në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve.

4. Skema e ndarjes së fondeve për përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara në pikën 3, pas hyrjen në fuqi të këtij udhëzimi do të jenë:

4.1 40% e fondit të përgjithshëm të subvencionit do të shkojë për mbulimin e “Kostos direkte të operimit” (në rastet e shoqërive me vlerë negative të diferencës së të ardhurave të faturuara - KDO).

4.2 60% e fondit të përgjithshëm do të shkojë për nxitjen e performancës së shoqërive, pavarësisht diferencës së kostos, bazuar në:

a) Pikët e arritura nga vlerësimi i treguesve të performancës së tyre në krahasim me objektivat. Për këtë, AKUM-ja harton matricën e performancës, ku liston pikët e realizueshmërisë për secilën sh.a. UK, të kontratës së performancës.

b) Në numrin e popullsisë së shërbyer.

5. Përfshihen nga përfitimi i subvencionit sipas përcaktimeve të bëra në pikën 4.1 të kësaj metodologjie, të gjitha shoqëritë e UK-ve, të cilave diferenca të ardhura – kosto direkte e operimit u rezulton me vlerë 0 ose është pozitive.

6. Përfshihen nga përfitimi i subvencioneve sipas përcaktimit të bërë në pikën 4.2 të kësaj metodologjie, shoqëritë e UK-së, në rastet kur:

- Nuk kanë të firmosur marrëveshjen e performancës midis AKUM-së (ish-AKUK) dhe bashkisë përkatëse;

- Nuk kanë dërguar të dhëna ose të dhënat nuk janë të sakta për vlerësimin e performancës së tyre sipas formatit të kërkuar nga AKUM-ja.

7. Për shpërndarjen e kështit të parë të subvencionit, sipas pikës 4.2, do të merret në analizë rezultati i vitit paraardhës. Për shpërndarjen e kështit të dytë të subvencionit, sipas pikës 4.2, do të merret në analizë, rezultati gjashtëmujor i vitit aktual, ushtrimor.

8. Subvencioni i akorduar nga buxheti i shtetit për shoqëritë e ujësjellës-kanalizimeve, do të përdoret

sipas përcaktimeve si më poshtë:

8.1 Në rastin kur fondi i subvencionit është dhënë me destinacion mbulimin e KDO-së, ai do të përdoret për blerje klori, si dhe për të paguar faturat e energjisë elektrike.

8.2 Në rastin e përfitimit të subvencionit, për arsye të nxitjes së performancës, shoqëria mund ta përdorë këtë fond, sipas prioriteteve të listuara më poshtë:

a) Për të përballuar efektet financiare në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 18, datë 12.1.2018, “Për subvencionimin e lidhjes së kontratave dhe vendosjen e matësve për kategoritë në nevojë”;

b) Për pajisjen me matës prodhimi dhe aparate klorifikimi;

c) Për pajisjen me matës konsumi;

d) Për të përballuar riparimet dhe mirëmbajtjet;

e) Për të përballuar riparimet dhe mirëmbajtjet kapitale të aseteve që zakonisht mbulohen nga vlera e amortizimit, pa tejkalluar vlerën e tij në koston e vitit;

f) Për financimin e projekteve të zbatimit, studimeve të fizibilitetit apo detyrave të projektimit për ujësjellës-kanalizime apo/dhe ITUN;

g) Për blerjen e makinerive, pajisjeve që ndihmojnë sh.a. UK në realizimin e objektivave, sipas biznesit planit të miratuar.

9. AKUM-ja, bazuar në vlerësimin e performancës të sh.a. UK-ve, brenda muajit shtator të çdo viti i propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, metodologjinë dhe skemën që duhet të zbatohet për ndarjen e fondeve, sipas përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.2 të kësaj metodologjie.

10. AKUM-ja brenda muajit maj, gusht, nëntor, shkurt, të çdo viti, i dërgon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën renditjen e shoqërive sipas performancës.

11. Ministria përgjegjëse për infrastrukturën, e cila bën çeljen e fondit të subvencioneve për sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, ushtron kontrolle periodike për të vlerësuar mënyrën e përdorimit të fondit të akorduar, për çdo ofrues shërbimi apo shoqëri që ka përfituar nga skema e subvencionimit”.